



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 05 Mars 2022

Nr: 12

**VENDIM**

**PËR**

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 06, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 05.03.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	Bele	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Demokratike, përfaqësuar nga avokati z. Marash Logu

**OBJEKT:** Kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 128, datë 05.03.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



## VËREN:

Partia Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 06 regj., datë 05.03.2022.

Në mbledhjen e datës 05.03.2022, ora 16:00, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 06 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 06, datë 05.03.2022, të paraqitur nga Partia Demokratike.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 5 Mars 2022, në orën 16:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

